



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

Manastirliu: Ndërtojmë një spital modern pediatrik në QSUT

2018-07-11 12:17:00



“Këtë vit nis investimi madhor 8 milion euro për rehabilitimin dhe zgjerimin e Pediatriisë”

Tiranë, 11 Korrik – Shërbimi i urgjencës pediatrike në Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza në Tiranë është rindërtuar me standarde bashkëkohore, duke ofruar një standard të ri shërbimi për pacientët.

“Po punojmë çdo ditë për të ndërtuar spitale miqësore me fëmijët. Sot kemi një urgjencë të re pediatrike, me më shumë hapësira dhe mundësi trajtimi në kushte dhe standarte bashkëkohore për pacientët e vegjël”, tha Ministria Manastirliu pas vizitës në ambientet e reja të Urgjencës Pediatrike.

Manastirliu lajmëroi gjithashtu fillimin e punimeve për rindërtimin dhe zgjerimin e Pediatriisë së QSUT-së.

“Jemi ambiciozë për të realizuar një ndërhyrje që do t'i ndryshojë krejtësisht pamje Pediatriisë këtu në QSUT, investimi madhor rreth 8 milion euro në kuadër të projektit të qeverisë shqiptare me Bankën Botërore, që do të rehabilitojë dhe zgjerojë Pediatriinë. Falë kësaj ndërhyrje, që do të nisë këtë vit, do të kemi një spital pediatrik modern, sipas standarteve europiane”, u shpreh Manastirliu.

E pyetur në lidhje me fluksin në këtë spital, Ministria Manastirliu tha se të dhënat e këtij 6-mujori flasin për një ulje të fluksit krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, edhe për faktin se popullata është më e ndërgjegjësuar dhe padyshim shërbimi parësor është përmirësuar.

Në urgjencën pediatrike të QSUT-së, e cila trajton rreth 100 mijë pacientë në vit është ulur koha e pritjes për pacientët e vegjël për arsye të triazhimit, pra diferencimit të rasteve të urgjencave si dhe futjes së sistemit të ri elektronik të menaxhimit të rradhës për pacientët.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale deklaroi gjithashtu se do të vijojnë projektet për tjetërsimin e pediatrive në spitale miqësore, në të gjithë Shqipërinë. Pas Vlorës, Elbasanit së fundi, së shpejti Fierit dhe me fillimin e punimeve për rehabilitimin dhe zgjerimin e Pediatriisë së Durrësit, zgjerohet harta e spitaleve miqësore me fëmijët.

###